




REPUBLIKA E KOSOVES/REPIUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br Prot. <u>01-1717/15</u>
Dep.	Prot No.
Nr. l. faq.	Data
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>29-06-2015</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	29.06.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abaz FONIQI Shef i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Klinës
CC:	z. Sokol BASHOTA Kryetar i Komunës së Klinës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit faza e dytë-Ritender "



I nderuari z. Foniqi,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " **Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit faza e dytë-Ritender** " me numër prokurimi: 634 15 031 521 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit faza e dytë-Ritender** " me numër prokurimi: 634 15 031 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Komuna e Klinës si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit faza e dytë-Ritender** " me numër prokurimi: 634 15 031 521, të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.18.06.2015. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 18.06.2015 tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar, **ka kërkuar: Referenca dhe Kontrata** kërkesë e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik e parasheh që Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë ta kërkojë për të dëshmuar aftësinë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.

Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit AKK ka vërejtur se në Dosjen e Tenderit tek rubrika Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare është kërkuar Raport financiar nga banka – mbi qarkullimin e ndërmarrjes apo bilancin e gjendejs nga ndonjë ndo një audit i pavarur në periudhat 2012-2013-2014. Me legjislacionin në fuqi për prokurim publik parashihet që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuar **nga një kompani e licencuar e auditivit me reputacion** e jo nga ndonjë audit i pavarur sikurse e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues.

Në Dosjen e Tenderit tek rubrika Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar Kontrata për punë të kryera në këtë lëmi të ndërtimeve të kësaj natyre në vitet 2012-2013-2014 së paku tri nga lëmia e ndërtimit të objekteve, me referenca në akordim me kontratat e prezantuara, kërkesë kjo në kundërshtim me ligjin, pasi që Legjislacioni në fuqi e parasheh se Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë të kërkojë tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale.

AKK gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit në rubrikën 13.2-Siguria e Tenderit, autoriteti kontraktues ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë 3% nga vlera e ofertës me validitet **60 ditë**, si dhe tek rubrika 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë **60 ditë**.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik, siguria e tenderit duhet të kërkohet si shumë fikse dhe jo në përqindje dhe do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë(30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues dot duhej që validitetin e sigurisë së tenderit ta kërkonte në periudhë prej **90 ditëve**.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe nenin **23** Kriteret e Përzgjedhjes dhe nenin **26** Siguria e Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

